



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10¹ dhe 13 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-108 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-108 datë 17.3.2023, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1188/11 datë 21.03.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023 miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqje të lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, nr.08-50 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzion, ark.nr.02-1007/17 datë 8.3.2023, e miratoi propozimin e Drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-108 datë 7.3.2023, dhe inicio procedure për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, nr.08-50 datë 5.1.2015, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1021/1 datë 6.3.2023, u konstatua se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së (lëshuar) dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, respektivisht nuk ka paguar kompensim (tarifë) vjetore për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, Agjencia më 9.3.2023, transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.08-108 datë 9.3.2023, për njoftimin se nëse nuk paguan kompensimin (tarifën) vjetore të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 17.3.2023 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për finansa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim me ark.nr.05-1021/2 datë 17.3.2023 se SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles, më 16.3.2023. ka bërë pagesë në shumë prej 65.540,00 (gjashtëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e dyzet) denarë, nga ku transmetuesi kompensimin (tarifën) vjetore për lejen e transmetimit në radio e ka paguar plotësisht.

Уп1 Бр.08-108

Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Rrjedhimisht siç u theksua më lartë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10 dhe 13 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-108 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-108 datë 17.3.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1188/11 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, vendosi të ndërpresë procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, është marrë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.

¹ Алинеите 8 и 9 се избришани, види: член 8 од Закон за изменување и дополнување на Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги („Службен весник на Република Македонија” бр.248/18).